


INTERVISTA E KARRIERËS

PËRGATITJA

Fizike: intervista duhet të jetë një mjedis mikpritës pa tërheqje vëmendjeje fizike ose dëgjimore. Intervista është një takim konfidencial dhe është e rëndësishme të garantohet që ajo nuk po përgjohet.

Personale: intervista duhet të garantojë që mësuesit kanë të gjithë informacionin e nevojshëm për nxënësit për sa i përket situatës së tyre aktuale dhe duhet të jenë që qartë për qëllimin e intervistës.

Procesi i intervistës



REHATIMI

Intervistuesi ka nevojë të sigurohet që nxënësit ndihen rehat gjatë intervistës dhe që ata/ato kuptojnë qëllimin e asaj që po bëhet.

Prandaj, është e rëndësishme që:

- Të shpjegoni arsyen e intervistës;
- Të kontrolloni nëse hollësitë për nxënësin janë të sakta;
- Të pyetni nxënësin se çfarë dëshiron të arrijë ai nga intervista – për çfarë ndihme ka nevojë;
- Të shpjegoni arsyen pse intervista është konfidenciale;
- Të bini dakord se çfarë doni të diskutoni gjatë intervistës;
- T'i tregoni nxënësit se cilat janë ato gjëra që nuk mund të arrihen gjatë intervistës.

HULUMTIMI I KARRIERËS

Kjo është faza diagnostifikuese e intervistës. Intervistuesi duhet të identifikojë problemin/çështjet e karrierës dhe të sqarojë situatën.

Gjatë kësaj faze ju duhet:

- Të pyesni për pëlqimet/ mospëlqimet/ interesat/ aspiratat e nxënësit, të ndërtoni një panoramë dhe të hartoni një raport të mirë me nxënësin;
- Të kontrolloni kuptimin duke i'a përsëritur nxënësit informacionin (reflektimin);
- Të prezantoni ide alternative/ alternativa për diskutim të mëtejshëm;
- Të bëni përmbledhje dhe të jepni opinion për situatën.


HARTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Sapo intervistuesi të kuptojë qëllimet e karrierës dhe pengesat/çështjet potenciale, ai do të jetë i aftë të punojë me nxënësin për të prodhuar një plan veprimi për karrierën.

Gjatë kësaj faze:

- Përmbledhni informacionin dhe diskutimin;
- Përcaktoni qëllimet (trajnim/ arsimim i mëtejshëm/ punë);
- Kërkoni opinione nga nxënësi për të parë nëse ai/ ajo mendon se intervista ka qenë me vlerë;
- Ofroni mbështetje të mëtejshme nëse është e nevojshme.

FAZAT E INTERVISTËS



DEKLARATA E KONFIDENCIALITETIT

Kur fillojmë një intervistë tek-për-tek është e rëndësishme të fitojmë besimin e nxënësit për t'u siguruar që ai/ajo është i aftë të flasë lirshëm. Ai/Ajo ka nevojë të sigurohet që diskutimi do të jetë konfidencial dhe që është i/e lirë të diskutojë çdo çështje apo problem që mund të ndikojë në marrjen e vendimit për karrierën e tij/saj. Kjo do t'i mundësojë intervistuesit të ketë mundësi të plotë për të marrë informacion në lidhje me faktet dhe pengesat e mundshme për të arritur suksesin. Ju takon juve të vendosni për fjalët që do përdorni por është e rëndësishme të përçoni këtë mesazh. Të thoni thjesht "çdo gjë është konfidenciale" nuk është e saktë dhe mund të jetë ç'orientuese.

Disa sugjerime për deklaratën e konfidencialitetit:

- ✓ *"Shumica e gjërave për të cilat ne do të flasim do të jenë konfidenciale, por mund të ketë gjëra që ti mund të më tregosh për të cilat ligji me detyron t'i raportoj, dhe unë do të tregoj nëse një gjë e tillë është e nevojshme."*
- ✓ *"Këtë diskutim do ta trajtoj si konfidencial, por mund të ketë informacion që unë do të kem nevojë ta ndaj me të tjerë, veçanërisht nëse ti je në rrezik. Nëse ndodh një gjë e tillë, do të të informoj."*
- ✓ *"Shumica e asaj për të cilën ne do të flasim është konfidenciale, duke përjashtuar rastet nëse ti dëshiron apo unë e gjykoj të nevojshme që duhet të flas me dikë."*

MOTIVIMI

Edhe pse disa nxënës janë të motivuar në mënyrë të natyrshme, ata mund të kenë ide të mira dhe duan t'i bisedojnë me këshilluesin, dhe janë të lumtur të angazhohen në procesin e intervistimit. Ka të tjerë që janë më pak të prirur të flasin për të ardhmen e karrierës së tyre për një numër arsyesh të ndryshme. Disa prej tyre mund të kenë pasiguri për marrjen e vendimit, disa të tjerë mund të kenë pengesa të tjera që duhen kaluar dhe nuk ndihen mjaftueshëm të fortë për t'i kaluar ato. Ju duhet të përdorni pyetjet për të identifikuar se cilat janë arsyet që kanë çuar në këtë mungesë motivimi. Motivimi i ulët zakonisht është një mbulesë për ankthin, pasigurinë dhe mungesën e besimit tek e ardhmja. Aftësitë dëgjuese reflektive do të jenë shumë të rëndësishme gjatë intervistës.

Si t'i ndihmojmë ato që të bëhen më të motivuar?

- **Kur intervistoni nxënësin reflektoni arritjet e tij të mëparshme.** Kërkojini atij që të mendojë për shqetësimet që ka pasur përpara ngjarjes dhe se si është ndjerë pasi ka arritur suksesin. Është e rëndësishme që ato të kuptojnë që puna dhe këmbëngulja duan shumë përpjekje por siç edhe kanë zbuluar në të kaluarën, ndjenja e kënaqësisë pas ngjarjes i bën ato të kuptojnë që ajo ka pasur vlerë.
- **Përqendrohuni tek pozitiviteti dhe çfarë ka arritur nxënësi.** Disa nxënës humbasin motivimin dhe kanë një vlerësim të ulët të aftësive të tyre. Atyre duhet t'i kujtohet që ato kanë arritur disa nivele suksesi – edhe pse të vogla – dhe ato janë të aftë për suksese në të ardhmen.
- **Përpikuni të nxirrni nga nxënësi fjali vetë-motivuese.** Mënyra si ato ndihen për veten e tyre është shumë e rëndësishme. Nëse ato mendojnë se do të kenë sukses,

ka mundësi që do të kenë, nëse ato mendojnë që nuk do t'ja dalin, ndoshta do të kenë të drejtë. Nëse ato fillojnë ta shohin veten si të suksesshëm dhe fillojnë të marrin në konsideratë mënyra se si ta arrijnë atë sukses ata do të fillojnë të përdorin një fjalor më optimist. “Do të bëhen inxhinier kur të mbaroj shkollën” përshtkruan qëllimin e tyre në ndryshim nga “Unë nuk mendoj se do të jem i aftë të marr nota të mira”.

- **Përcaktoni qëllime të arritshme - ndajini veprimet në hapa të vegjël.** Kur nxënësi është i aftë të identifikojë se çfarë do të bëjë kur të largohet nga shkolla, është e rëndësishme ta ndihmojmë atë të përcaktojë qëllime të arritshme dhe të punojë për qëllimin final. Sapo ai/ajo të arrijë një nga qëllimet, ai/ajo do të jetë i/e aftë të kuptojë që sukcesi varet nga ai/ajo. Nëse ai/ajo dështon në arritjen e qëllimeve, është gjithashtu e rëndësishme që të shihen arsyet sepse kjo do ta ndihmojë atë të mendojë për veprime alternative që të mund të çojnë drejt suksesit.

Aftësitë dëgjuese

Pse dëgjojmë ne?

- Për të ndërtuar një marrëdhënie;
- Për të marrë pjesë në historinë e dikujt;
- Për të dëgjuar eksperiencat dhe ndryshimet e tyre;
- Për të marrë informacion dhe për të dëgjuar opinionet e tyre;
- Për të mbajtur nën kontroll situatën (Informacioni është fuqi);
- Për të respektuar dhe vlerësuar të tjerët.

Si mund ta ndihmoni veten për të dëgjuar më mirë?

Duke “dëgjuar në mënyrë aktive” – kur jemi duke bërë një intervistë është e rëndësishme të mbajmë mend që nuk jemi duke bërë një bashkëbisedim. Ju jeni aty për të ndihmuar të intervistuarin dhe duhet të përqendrohemi gjithmonë në atë që nxënësi është duke thënë – ai është pika kyçe në atë moment dhe ju nuk jeni aty për të ndarë eksperiencat apo mendimet tuaja por për të reflektuar, për të dhënë opinion dhe për të bërë përmbledhje të asaj që ai do të thotë.

Aftësitë për të bërë Pyetje

Pyetjet/Deklarimet	Të dobishme	Të padobishme
Të hapura – “Më trego rreth” inkurajon individin për të folur	Për të eksploruar dhe për të mbledhë informacion.	Me individë që flasin shumë. Aty ku kërkohet një qasje e disiplinuar.
Kontrolli – “Çfarë ndodhi ekzaktësisht pas kësaj?” Është shumë e rëndësishme për të marrë hollësi: Ndjek pyetjet e hapura për të qartësuar çfarë ka dashur të thotë individi.	Përcaktimi dhe kontrolli i hollësive të ngjarjeve dhe informacionit tashmë të njohur që sapo ka dalë nga pyetjet e hapura.	Eksplorimi i momenteve me ngarkim emocional.
Të mbyllura – “Sa ishin atje? E ngushtë, përcakton pika fakti specifike.	Për të kontrolluar faktet e vetme.	Për të marrë informacion në lidhje me disa fusha për të cilat nuk merret gjithmonë informacion.
Reflektuese – “Ndjeheni i trishtuar për vendimin?” Shumë e fuqishme. Përsëriteni tekstualisht përmbajtjen emocionale të deklaratës së një individi.	Për të zgjidhur probleme. Për situatat e ngarkuara emocionalisht	Nëse thuhet në këtë mënyrë mund të mos lejë vend për komente të mëtejshme.
Drejtuese – “Unë mendoj që ti je dakord me këtë, apo jo”. Drejton tek përgjigja që ju prisni.	Për të marrë miratim të pikëpamjes tuaj.	Për të marrë çdo lloj informacioni.
Hipotetike – “Çfarë do të bëje nëse...?” Paraqet një situatë hipotetike për të ardhmen.	Të bëjë individin për të menduar për gjërat e reja.	Me individë që kanë nevojë për kohë për të dhënë një përgjigje të arsyeshme.
Të shumëfishta – disa pyetje/përgjigje	KURRË	GJITHMONË

Pyetje që mund t'i bëjmë të rinjve

ÇFARË INFORMACIONI MUND TË DUHET TË MARRIM NGA NXËNËSI?	SHEMBUJ TË PYETJEVE QË MUND TË BËJMË
<p>Cilat janë nevojat e nxënësit? Jepuni prioritet nevojave të tyre - bini dakord për një program.</p>	<p>Si mund të të ndihmoj? Për çfarë ke dëshirë që të flasim? Për çfarë ke dëshirë që të flasim së pari? Në çfarë rendi do t'i diskutojmë këto gjëra? Ne kemi X afat kohor, a je dakord me këtë?</p>
<p>Çfarë informacioni paraprak ke nevojë të kesh? Arsimimi – kualifikimet, lëndët aktuale Punësimi Përvoja e punës</p>	<p>A mund të më tregosh pak më shumë në lidhje me këtë? Për çfarë kualifikimesh je duke studiuar? A ke mbështetje nga shkolla? Cilat lëndë të pëlqejnë/nuk të pëlqejnë? Pse? A ke ndonjë përvojë pune?</p>
<p>Cilat janë idetë aktuale të nxënësit? Sa i ka menduar nxënësi alternativat e tij? Sa i mirë-informuar është nxënësi/nxënësja për alternativat e karrierës që ka në mendje? Sa realist është ai? A e di ai se çfarë tjetër mund të bëjë? Sa i përkushtuar dhe i motivuar është ai/ajo? Çfarë dinë ato për teknikat e kërkimit të punës apo trajnimeve?</p>	<p>Çfarë idesh ke në lidhje me karrierën/punën (nëse ka ndonjë)? Çfarë të pëlqen në lidhje me këtë ide? A ke menduar për ndonjë ide tjetër? Nëse po, çfarë? Në çfarë mendoni se duhet të jeni të mirë në lidhje me atë ide? Sa ju përshtatet ajo? A ka ndonjë gjë në lidhje me atë ide që ju bën të mos e pëlqeni? Sa kohë keni që e keni këtë ide? Çfarë mendojnë prindërit në lidhje me të? A ka probleme shëndetësore që mund të ndikojnë tek zgjedhja jote? A e dini se si mund të fitoni kualifikimet e nevojshme për atë punë?</p>
<p>Në çfarë mase ka punuar nxënësi për hapat praktikë që janë të nevojshëm për arritur qëllimin e karrierës së tij/saj? Cilat pika veprimi janë realiste dhe të arritshme?</p>	<p>Çfarë mendoni se duhet të bëni më tej? Kur mendoni se mund ta bëni këtë gjë? A keni nevojë për ndihmë?</p>
<p>Vlerësimi – Sa ndihmëse ka qenë kjo për nxënësin?</p>	<p>A ka qenë ndihmuese kjo? Në çfarë mënyre të ka ndihmuar?</p>
<p>Çfarë ndihme apo mbështetjeje të mëtejshme do të pëlqente nxënësi?</p>	<p>A do të doje të më takoje përsëri? Kur do të doje të vije përsëri?</p>

Fletë Pune: Pyetjet

Të radhitura më poshtë janë disa pyetje që mund të bëhen gjatë intervistës. Ju lutem shqyrtoni çdo pyetje me radhë dhe vëni një vlerësim nga 0 deri në 5 (0 përfaqëson një pyetje shumë jo efektive dhe 5 një pyetje shumë efektive). Ju mund të doni gjithashtu të shtoni komente mbështetëse në hapësirat boshe.

Nr.	Pyetjet	Vlerësimi:
1.	Cilat janë hobitë e tua?	
2.	Çfarë pune dëshiron të bësh?	
3.	Unë e di që rroga nuk është shumë e mirë, por çfarë mendon në lidhje me një kurs trajnimi?	
4.	Atëherë, kjo përvojë pune nuk shkoi shumë mirë. Pse? Për shkak të orëve të punës, punës apo njerëzve me të cilët ke punuar?	
5.	Mesa po shoh je i interesuar për futbollin. A mund të më tregosh më shumë në lidhje me këtë gjë?	
6.	Çfarë ke bërë për të gjetur një punë?	
7.	Si ndjehesh në lidhje me shkollën/punën në këto momente?	
8.	Si the se quheshe?	
9.	Me sa po kuptoj e pëlqen muzikën. A i bie një instrumenti?	
10.	Dëshiron të bëhesh doktor?	
11.	Do të pëlqente një punë si shofer apo jo?	
12.	Çfarë cilësish mendon se të duhen për t'u bërë stjuardesë?	
13.	Fizioterapia është një punë shumë kërkuese. A mendon se je i aftë të përballësh me kërkesat e punës? A do të arrish rezultate të mira në shkollë? A e di që për këtë profesion kërkohet që të kesh rezultate të mira në shkollë?	
14.	A je i sigurt që do të bëhesh fermer? Me sa di unë kjo është një punë shumë e vështirë dhe jo shumë e paguar.	

REFLEKTIMI

Katër nivelet e reflektimit

Reflektimi në lidhje me informacionin që ju është dhënë nga nxënësi është i rëndësishëm nëse dëshironi ta ndihmoni atë. Kjo ju ndihmon ju të qartësoni çfarë ju është thënë dhe i jep nxënësit mundësinë për t'ju korrigjuar nëse ju keni keqkuptuar ato që po thuhet.

Duke përsëritur një element të asaj që një nxënës thotë.

Duke përmbledhur pak atë që nxënësi thotë.

Duke parafrazuar – ju kuptoni atë që nxënësi tha dhe e reflektoni me fjalë të tjera.

Reflektimi i ndjenjave - Ju parafrazoni dhe theksoni dimensionin emocional përmes deklaratave të ndjenjave

VËNIA NË SFIDË

Hapat e vënies në sfidë

- Të ofroni interpretimin tuaj të situatës;
- Të dëgjoni me kujdes;
- Të njihni ndjenjat e nxënësit;
- Të reflektoni;
- Të zhvilloni një perspektivë të re;
- Të gjeneroni një linjë veprimi.

Kur duhet të vëmë në sfidë

- Mungesë të pranimet të problemeve;
- Interpretime të gabuara të përvojave, sjelljeve dhe ligjeve;
- Hezitim për të ndërmarrë veprime ndaj perspektivave të reja;
- Interpretime që nuk përputhen ose informacion i pasaktë.

Parimet e vënies në sfidë

- Të mbahen mend qëllimet e vënies në sfidë;
- Të njihen tiparet pozitive të situatës së nxënësit;
- Të ofrohet sfida;
- Të punuarit me nxënësin për të arritur një veprim më pozitiv.

Si mund t'i sfidoni këto nxënës?

Ermira dëshiron të bëhet doktoreshë. Megjithatë, ajo ju thotë që nuk i pëlqen lënda e kimisë. Ajo preferon të përqendrohet tek biologjia dhe të mos vazhdojë kursin e kimisë.

Cila do të ishte përgjigja juaj?

Arbeni ka shkruar në pyetësorin përpara intervistës se ai preferon artin dhe lëndë të tjera praktike në shkollë. Ai gjithashtu deklaroi se ka dëshirë të bëhet berber. Kur ju e takoni, ai duket shumë i turpshëm dhe i qetë dhe nuk e përdor fare kontaktin sy-më-sy.

Cila do të ishte përgjigja juaj?

Andit i intereson të bëhet auto-mekanik. Ai nuk ka eksperiencë praktike në këtë fushë dhe nuk dëshiron të shkojë në shkollë.

Cila do të ishte përgjigja juaj?

PËRMBLEDHJA

Gjatë intervistës një 'mjet' i dobishëm është përmbledhja e cila shërben për të theksuar se ku jemi me diskutimin. Kjo shërben për të reflektuar çfarë është thënë deri tani dhe për t'ju dhënë ju kohë për të menduar për fazën që vjen. Në fund të intervistës është e dobishme të përmbledhet ajo që është thënë dhe të ri-thuhet ajo që do të ndodhë më tej.

Kur duhet të bëjmë përmbledhje?

- Në fillim të intervistës;
- Gjatë intervistës;
- Në fund të intervistës.

Pse?

- Për të kontrolluar të kuptuarit;
- Për të qartësuar;
- Për të përforcuar;
- Për të theksuar pikat e ndërlidhura;
- Për të vepruar si një tabelë treguese për fazën tjetër të intervistës.

Gjithashtu:

- Është e rëndësishme që intervistuesi të përdorë përmbledhjet rregullisht;
- Mbani mend të siguroheni që nxënësi është dakord me përmbledhjen;
- Është një mjet i dobishëm kur intervista/diskutimi është bllokuar dhe nuk po ecën.

MBYLLJA E INTERVISTËS

Në fund të intervistës ju duhet:

- Të parafrazoni dhe ritheksoni pikat kryesore të diskutuara;
- Të përpiqeni të kufizoni përmbledhjen në pikat kryesore;
- Të kontrolloni së bashku me nxënësin nëse përmbledhja është e saktë (ose ta ftoni nxënësin që ta bëjë vetë përmbledhjen);
- Ta bëni nxënësin të sugjerojë hapa të mëtejshëm dhe afate kohore;
- Të shkruani hapat për të cilët keni rënë dakord;
- Të theksoni edhe një herë se nëse nxënësi ka nevojë mund të takohet përsëri me Ju;
- T'i kërkonte opinione nxënësit se si shkoi intervista.